



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2614/ 4 prot

Datë 15.11.2023

V E N D I M
Nr. 1156 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.11.2023 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-84355-10-19-2023, me objekt: “Mirëmbajtje dhe përmirësim i sistemit të taksave dhe financës”, me fond limit 1,083,333 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK, me Nipt L42202028V dhe Adresë: Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati Viridario 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Elbasan.
Adresa: Rr “Qemal Stafa” Elbasan.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.10.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-84355-10-19-2023, me objekt: “Mirëmbajtje dhe përmirësim i sistemit të taksave dhe financës”, me fond limit 1,083,333 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ka depozituar ankesë operatori ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK me nr. ankimi elektronik A/2023/3536, datë 25.10.2023 dhe me nr. 2614 prot., datë 25.10.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Operatori ankimues ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën Formular i Ankesës, protokolluar me Nr.2614/2, datë 27.10.2023.

II.5.Me shkresën nr. 5780/6 prot., datë 01.11.2023, me objekt: “Dërgim Informacioni”, protokolluar me tonën nr. 2614/3 prot, datë 06.11.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “PRIMUS ALBANIA” SHPK lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

Referuar shkresës të mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “PRIMUS ALBANIA” SHPK dhe me Vendimin nr.5780/6 prot, datë 31.10.2023, ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik për pikën e parë të ankesë vëren se:

Autoriteti Kontraktor me Vendimin e KSHA-së nr. nr. 5780/6 prot, datë 31.10.2023 me objekt: “Vendimi i shqyrtimit të ankesës së “PRIMUS ALBANIA” SHPK”, protokolluar me tonën nr. 2614/3 prot, datë 06.11.2023, trajtoi ankesën në lidhje me pretendimet e ankimuesit me argumentet si vijon:

- Në lidhje me pretendimet mbi modifikim të pikës:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatorit ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po



Jo



Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

Duke e konsideruar si të paplotë dhe në kundërshtim me ligjin, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin e kësaj të dhëne.

- KSHA me Vendimin e saj pranon këtë pikë të ankesës: “AK ju sqaron se pretendimi juaj qëndron dhe do të bëjë ndryshimet përkatëse në DST”.

- Në lidhje me pretendimet mbi modifikim të pikës:

3.1.2 Autoriteti/enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor **405279562**(*të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor*) *Duke e konsideruar si të paplotë dhe në kundërshtim me ligjin, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin e kësaj të dhëne.*

- KSHA me Vendimin e saj pranon këtë pikë të ankesës: “AK ju sqaron se pretendimi juaj qëndron dhe do të bëjë saktësimin e nevojshëm në DST”.

- Në lidhje me pretendimet mbi modifikim të pikës:

Në pikën 2.3.3 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si më poshtë

- Te paktën 1 (një) specialist i certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)
- Operatori ekonomik duhet të ketë te paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si “Ekspert të Certifikuar” në zhvillim dhe implementim të zgjidhjes që AK ka në përdorim.
- Operatori ekonomik duhet të ketë te paktën 1 specialist të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojnë që programuesit janë të aftësuar në zhvillimin e sistemeve me arkitekture të prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara.

Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikates perkatëse për punonjësit. Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime

Në vetë objektin e kontratës dhe specifikimet teknike të shërbimit të kërkuar nuk jepet informacioni që sistemi i implementuar TAIS që AK ka në përdorim është i integruar/bashkëvepron apo do të integrohet/bashkëveprojë me sisteme të tjera për të cilat raste do të ishte i nevojshëm certifikimi SOAP. Pra, ky kriter është jo në përpjesëtim me detyrat që duhet të kryejë kontraktori në përmbushje të kontratës referencë Referuar sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke përcaktuar qartë stafin e certifikuar sipas natyrës së shërbimeve të kërkuara dhe numrin e punonjësve sipas certifikimeve të nevojshme, kjo në përputhje me përcaktimet, kërkesat ligjore dhe natyrën e shërbimeve që kërkohen.

- KSHA me Vendimin e saj pranon këtë pikë të ankesës: “AK ju sqarohet se gabimisht nuk është dhënë informacion në lidhje me programin që AK ka në përdorim i cili është si më poshtë.

Sistemi i implementimit aktualisht për administrimin e taksave, tarifave, shërbimeve (TAIS) të Bashkisë Elbasan është i tipit COTS (Comercial Off The Shelf) duke i bazuar nga ana teknologjike në paketa ndërkombëtare më të mira , pjesë e modelit të implementuar në 10 njësi të qeverisjes vendore i financuar nga USAID. Zgjidhja është bazuar në Microsoft Dynamics Nav 2013 R2 dhe është përshtatur sipas kërkesave të brendshme të institucionit si dhe legjisllacionit në fuqi për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

III.1.1. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK me nr. 2614 prot, datë 25.10.2023, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-84355-10-19-2023, me objekt: “Mirëmbajtje dhe përmirësim i sistemit të taksave dhe financës”, me fond limit 1,083,333 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

Komisioni do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III 2. Në lidhje me pretendimet mbi modifikim të pikës të shtojcës 6 me argument:

Në Shtojca 6, Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit, në tabelën në kolonën Vlera pa TVSH keni vendosur vlerën 1,083,333 L pa TVSH të njëjtën me fondin limit,

Nr.	Përshkrimi	Afate	Sasia	Cmimi pa t.v.sh.	Vlera pa t.v.sh.
1	Mirembajtje dhe përmirësim i sistemit të taksave TAIS	12 muaj			
	TOTALI PA TVSH				1’083’333
	TVSH				
	VLERA ME TVSH				

Vendosja e një vlerë të tillë krijon konfuzion,... Duke e konsideruar si një gabim, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për modifikimin e kësaj të dhëne.

III.2.2.. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 Parime të përgjithshme *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin*

mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 77 i Ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.3. Neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pikat 2,4,6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
 - b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
 - c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
 - ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
 - d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*
5. *Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:*
- a) *operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
 - b) *operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.*
 - c) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.*
 - ç) *operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.*
6. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*
7. *Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.*

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik referuar dokumenteve të tenderit sjell në vëmendje, se Autoriteti Kontraktor publikon dokumentet e procedurës së prokurimit, duke u bazuar në dokumentet standarde të tenderit (formatet) të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik, me Vendimet përkatëse “Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit”, nga Agjencia e Prokurimit Publik, si i vetmi Institucion kompetent. APP vendos në dispozicion nëpërmjet mjeteve elektronike procedurën për paisjen e operatorëve ekonomikë me këto dokumente. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, dhe Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshirë të paktën: termat e referencës; Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit; etj.

Autoriteti kontraktor është përgjegjës për barazvlefshmërinë e kopjes së sipërpërmendur, së bashku me dokumentet e tenderit të hartuara nga njësi e prokurimit dhe që administrohen prej tij.

Referuar ankesës në lidhje me paqartësi në Formularin e Shërbimit dhe Grafikut të Ekzekutimit, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë vetëm të dhënat që i kërkojnë konkretisht në këtë formular dhe pjesa tjetër mbetet të plotësohet nga operatorët ekonomikë ofertues, në fazën e përgatitjes së ofertave të tyre.

Për sa arsyetuar më sipër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë setin e DST, duke korrigjuar gabimet apo pasaktësitë, konstatuar dhe ankimuar me të drejtë nga operatori ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me ankesën mbi modifikim të Shtojcës 8 me argumente:

Në pikën **2.3.1**. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, me një vlerë **jo më të vogël se 20%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatore Ekonomik duhet të paraqesin:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, **ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Në paragrafin e dytë AK ka vendosur si kusht “**ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes...**” duke hequr lidhësen “ose” përpara lidhëses “dhe” siç përcakton VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pra formulimi juaj bie në kundërshtim ku shprehet “... ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes...”*

Duke e konsideruar si një formulim në kundërshtim me përcaktimet nënligjore në fuqi, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për modifikimin e këtij kriteri.

III.3.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA sqaron këtë pikë të ankesës: “AK ju sqarojmë se sipas përcaktimeve të VKM-së ... lidhësja **dhe** nënkupton që AK i kërkon të dyja dokumentet” .

III.3.2. Komisioni i Prokurimit, referuar dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, vëren se Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit. Në çdo rast është në të drejtën e tij të vendosë kritere për kualifikim për t'u siguruar mbi kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues të mundshëm në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret mbi formulimin e kriterit **2.3.1**. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar në mënyrë të qartë dhe në përputhje me objektin e prokurimit kriterin 2.3.1, objekt ankimi, i cili nuk rezulton të jetë kufizues dhe as konfuz, përkundrazi i shërben autoritetit kontraktor të sigurohet për eksperiencë të mëparshme vërtetuar me dokumentacion provues, si një e drejtë e vetë autoritetit kontraktor.

Për sa referuar më sipër, si edhe në referim të Vendimit të KSHA-së, Komisioni gjykon, se kriteri 2.3.1 është i formuluar saktë dhe nuk përbën pengesë për operatorët ekonomikë.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.4 Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik për pikën 5 të ankesës mbi modifikim të Shtojcës 8 me argument:

Në pikën 2.3.3 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) specialist i certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)
- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si “Ekspert të Certifikuar” në zhvillim dhe implementim e zgjidhjes që AK ka në përdorim.
- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 specialist të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve dhe protokollit SOAP. Këto certifikata garantojnë që programuesit janë të aftësuar në zhvillimin e sistemeve me arkitekture të prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara.

Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit. Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime

Referuar këtij kriteri del e qartë që është kërkuar 1 (një) specialist që të jetë i certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web dhe në protokollin SOAP.

Së pari, kërkesa që një specialist të ketë më shumë se një certifikatë kufizon në mënyrë të padrejtë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit, cenon parimet bazë të ligjit të prokurimit publik dhe konkretisht: i) redukton pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ii) redukton konkurrencën ndërmjet operatorëve; iii) nuk siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Së dyti, referuar kriterit dhe konkretisht “operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e web sherbimeve”, shtojcës 5 specifikimeve teknike, dhe bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të

kontratës objekt-prokurimi, kriteri për disponimin e 1 (një) punonjësi të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e web shërbimeve është i ekzagjeruar dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Në specifikimet teknike të shërbimit të kërkuar nuk del askund nevoja e AK për Web shërbime. Pra, ky kriter është jo në përpjesëtim me detyrat që duhet të kryejë kontraktori në përmbushje të kontratës referencë.

Së treti, referuar kriterit dhe konkretisht operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 specialist të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e ueb shërbimeve dhe protokollit SOAP të, shtojcës 5 specifikimeve teknike dhe bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, **kriteri për disponimin e 1 (një) punonjësi të certifikuar për protokollin SOAP** është i ekzagjeruar përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

III.4.1. Autoriteti Kontraktor në DST ka publikuar shtojcat 7 dhe 8 si vijon:

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Mirembajtje dhe përmirësim i sistemit të taksave dhe financës.

Sherbime te kerkuara

Permirsime te funksionaliteteve te sistemit te taksave TAIS

1. Përditsimi i QKB (QKR).Sistemi duhet të marre automatikisht të dhenat dhe ti pasqyroje në sistem.
2. Specifikimi informacionit të biznesit, nëse është Biznes i madh apo Biznes i vogël, tek kartelat e taksapaguesit.
3. Raport në lidhje me numrin e bizneseve të reja dhe bizneseve të mbyllura gjatë një periudhe të caktuar(psh e ndare në çdo muaj)
4. Raport në lidhje me numrin e taksapaguesve – biznes i madh dhe numrin e taksapaguesve biznes i vogël
5. Raport në lidhje me taksapaguesit debitore për kategori të ndryshme taksapaguesish (biznes i madh, biznes i vogël, lloji i industrisë, lloji i aktivitetit)
6. Raport në lidhje me taksapaguesit debitore për kategori të ndryshme taksapaguesish (biznes i madh, biznes i vogël, lloji i industrisë, lloji i aktivitetit)
7. Gjenerimi i raporteve të ndryshme për bizneset sipas kërkesë së Bashkisë (psh raporti sa biznese të vogla/biznese të mëdha janë hapur për çdo vit kalendarik, sa biznese të vogla/biznese të mëdha janë mbyllur etj.
8. Gjenerimi i raporteve të specifikuar për llojet e taksave dhe tarifave vendore për çdo vit kalendarik.

9. Aplikim për paisje me Njoftim Detyrimin dhe Faturen se Taksave vendore nëpërmjet platformës elektronike E-Albania.
10. Aplikim për paisje me vërtetim për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore nëpërmjet platformës elektronike E-Albania.
11. Kur regjistrohet një biznes në fushën ku vendoset NIPT duhet të ketë mekanizëm për mbrojtje nga gabimet. (Formati që pranon kjo fushë duhet të jetë vetëm në mënyrën shkronje – 8 numra -shkronje.)
12. Database i sistemit të taksave Tais ka kaluar kuotën që të lejon SQL expres. Kërkohej që SQL ekspres të kalojë në SQL standart. (License SQL Standart)
13. Duhet të rregullohet kamatvonesa pasi biznesi merr faturen. Duhet të ketë një periudhë 1 javore kamate të llogaritur. (fature + kamate për 1 javë, kohë e mjaftueshme për të bërë pagesën) nëse pagesa nuk bëhet për një javë të vazhdojë kamata.
14. Krijimi tek ndryshimi i statusit aktiv/pasiv të shtohet edhe një fushë për statusin aplikim për ç'regjistrim përfshirë datën.
15. Gjenerimi i statistikave për llojet e taksave dhe tarifave vendore për çdo vit kalendarik si dhe arkëtimet përkatëse për çdo zë të taksave dhe tarifave vendore.
16. Gjenerimi i statistikave për llojet e bizneseve sipas kategorizime (BM/BV si dhe lloj aktiviteti)
17. Zhvillimi i mëtejshëm të departamentit të transportit specifikisht krijimi i faturave për lincinat e karburanteve, krijimi i departamentit të hedhjes së pagesave për këto zëra.
18. Raport në lidhje me taksapaguesit debitore ku debia të jetë e ndarë sipas taksave dhe tarifave për çdo vit.
19. Raport në lidhje me lidhje me taksapaguesit për vlerën e arkëtuar për çdo taksë dhe tarifë vendore.
20. Çdo raport ekzistues në sistem.

Sherbime Mirembajtje për sistemin e taksave.

- Diagnostikim on site/on line, dhe mbështetje për "debugging" brenda ditës të punës nga njoftimi i Autoritetit Kontraktor dhe përfundim të veprimeve korrigjuese brenda 24-48 orëve nga ky njoftim.
 - Mbeshtetje me linjë telefonike në gjuhën Shqipe, pa limit orë përgjigje në një ditë pune.
- Emergjencja për thirrje, shërbim vizitash në vend (on site) brenda ditës së punës nga marrja e kërkesës së Autoritetit Kontraktor.
 - Shërbim on site / on line "për thirrje" për personalizimin e paketës së sistemeve, e vlefshme brenda ditës pasardhëse të punës.

- Asistence per *personelin IT* per:
 - Analize te te dhenave.
 - Gjenerim te raporteve te performances.
- Asistence per personelin e *Drejtore se Taksave*:
 - Proceset operacionale ditore
 - Gjenerim te raporteve periodike
- Helpdesk te jete aktiv 8 ore nga e Hena ne te Premten (08:00 – 16:30).
- Korrigjimi i gabimeve te funksionaliteteve.
- Ri-instalimi i sistemit me te gjithë komponentet e tij se bashku me konfigurimet perkatese per venien ne pune te sistemeve TAIS.
- Çdo ndryshim i kryer si pasoje e ndryshimeve ligjore financiare dhe fiskale duhet te kryhet me prioritet brenda nje afati te tille qe nuk do te sjelle pengese ne realizimin e detyrave te sektorit te taksave dhe financiar.
- Kompania duhet te jete disponibel per ndryshimet ne raportet perkatese sipas kerkeses se bere nga Bashkia Elbasan si per ato ekzistuese dhe per raporte te reja ne kuader te permiresimit te punes ne sektorin e te ardhurave dhe ate financiar.
- Ndryshimi i raporteve dhe faturave te cilet do te printohen ne pamjen vizuale mund te jene subjekt permiresimi.
- Konfigurimi i klienteve dhe userave te rinj apo i atyre ekzistues ne Bashkine Elbasan.
- Trajnimi i personelit perdorues per ndryshimet apo permiresimet e sistemeve ne ambjentet e Bashkise Elbasan.

Pergatitje te raporteve 3-mujore te detajuara lidhur me punen e kryer nga kompania

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sistemi i implementuar aktualisht per administrimin e taksave, tarifave, sherbimeve (TAIS) ne Bashkine Elbasan.

Shtojcën 8, 2.3. Kapaciteti teknik dhe profesional, Pikën 2.3.3

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si më poshtë:

- Te paktën 1 (një) specialist i certifikuar për menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)
- Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Çertifikuar” ne zhvillim dhe implementim e zgjidhjes qe AK ka ne perdorim.
- Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e Web sherbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.

Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesit. Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime.

III.4.2. Autoriteti Kontraktor ka publikuar ProcesVerbalin, (*Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit*), për kriterin objekt ankimi:

a. Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Certifikuar” ne zhvillim dhe implementim e zgjidhjes qe AK ka ne perdorim.

-Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesit

Argumentim: Qe te sigurohet nje mirembajtje sa me eficente e Programit te TAIS qe shoqeria ka ne perdorim, zgjidhja ne kohe e problemeve, etj, kerkohet qe Operatori Ekonomik te kete te punesuar te pakten 1 punonjes te certifikuar nga prodhuesi i teknologjive baze te sistemit. Punonjesi i certifikuar ne zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjes qe shoqeria ka ne perdorim Microsoft Dynamics NAV,ben te mundur qe zgjidhjet e probleme te behen brenda afateve te percaktuar ne SLA dhe ne kete menyre te mos krijohet asnje problematike ne sistemin TAIS. Ne kete menyre AK ka garancine qe te njihet mire sistemi aktual i Taksave dhe te mos krijohet asnje problematike qe mund te sjelle nderprerje te proceseve te rendesishme te faturimit dhe ne kete menyre te AK te arketoje pagesat e kryera. Ekspertet e certifikuar bejne te mundur qe realizimi i kontrates dhe specifikimeve te saj te jete sa me i plote, shterues dhe ne afatet e percaktuara duke bere te mundur mbarvajtjen normale te procesit te punes.

b. Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e Web sherbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.

-Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesin.

Argumentim: Specialisti i siperctuar nevojitet per te garantuar integrimin mes sistemeve te brendshme dhe me sistemet e paleve te treta. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.

c. Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)

-Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatese per punonjesin

Argumentim: Kerkesa per nje punonjes te certifikuar per "ITIL" ose ekuivalente lidhet me rezultatet qe duhet te permbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kerkesave te shprehura ne DST ku percaktohen kohet e nderhyrjeve dhe termat e tjera te nivelit te sherbimit SLA (sherbimet e mirembajtjes). Nje certifikim ITIL eshte nje set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh per realizimin e sherbimit ne teknologjine e informacionit dhe komunikimit, qe eshte pjese e qellimit te projektit te autoritetit kontraktor. Kerkesa per certifikim ITIL ose ekuivalente, i deshmon autoritetit qe operatori ekonomik, nepermjet stafit te certifikuar si me siper, garanton ideimin dhe konceptimin e sherbimeve IT te projektit ne menyre te menaxhueshme sipas standardeve nderkombetare te njohura, ne gjithe ciklin e tyre, perfshire ketu dhe sherbimet e mirembajtjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 9, te DT. Dokumentat e kerkuara me siper do te paraqiten nga OE i kualifikuar ne vend te pare perpara publikimit te njoftimit paraprak te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operoret ekonomike

te deshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret, që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar

kufijtë maksimale të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse këto kërkesa shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i cikleve cilësore të trajnimit dhe përmbushjes me sukses të kontratës. Gjithashtu gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat për disponimin:

Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 specialist të certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve dhe protokollit SOAP, nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit.

Në këtë mënyrë KPP gjykon, se certifikatat në fjalë (*certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve dhe protokollit SOAP*) nuk janë proporcionale me objektin e prokurimit, fondin limit dhe llojin e procedurës së prokurimit. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Në këtë kuadër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kërkesave: *certifikuar në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve dhe protokollit SOAP* të përcaktuara në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-84355-10-19-2023, me objekt: “*Mirëmbajtje përmirësim i sistemit të taksave dhe financës*”, me fond limit 1,083,333 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaïd Myzyri

